



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
Nr.01-060/01-16004/24 datë: 27.06.2024



Npi – 01/240 datë: 04.07.2024

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 04.07.2024, është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**P R O C E S V E R B A L**

I Mbledhjes së -VII-të, të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shtimes, mbajtur më datë 04.07.2024 (e enjte), në ora 09:00h, në sallën e Kuvendit.

Në mbledhjen e Kuvendit, kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Sanije Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Përparim Ramusa, znj.Adelina Beqaj, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrushi, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Rexhep Gashi dhe z.Reshat Mujota. Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, Z.Qemajl Aliu, Nënkyetari, z. Faruk Beqa, të gjithë Drejtoret, Shefja e Kabinetit, znj.Anita Kurti, nga Zyra për Informim, znj.Vlora Hyseni, nga RZSH - z.Muhamet Hoxha, nga KTV - z.Agim Ademi, zyrtari për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore z.Reshat Gashi, Zyrta i IT-së, Miftar Miftari, Asistentja e Kryesuesit, znj.Gentiana Mehmeti, Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, dhe pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshmë për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit, për këtë seancë kemi propozuar këtë:

**R E N D D I T E**

- Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 26.06.2024,
- Raporti i punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes për Janar-Qershori 2024,
- Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e drejtorave të Institucioneve lokale arsimore,
- Propozim-Vendim për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 100 euro për qdo muaj për familjet që strehojnë fëmijët pa përkujdesje prindërore.
- Informatë nga KKSB për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershori 2024,
- Pyetje – Përgjigje.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Para se të miratojmë rendin e ditës, unë propozoj që ta fusim si pikë e dytë shtesë, pas Prosesverbalit “Diskutim për deklaratën e avokatit z.Tomë Gashi për Reçakun”. Edhe pse unë e di që ai e ka përmirësuar deklaratën e tijë, është prononcuar rreth kësaj qështje, dhe ka bërë kërkim falje publike. Unë si Kryesues i këtijë Kuvendi nuk do të lejojë që tema e njeshme e Reçkut në këtë rast të përdoret për aspekte politike. Jam në dijeni për një kërkësë të opozitës për ta thirrë një mbledhje të Jashtëzakonshme për datën 04.07.2024 në ora 08:30h me gjysëm ore më heret se mbledhja e rregullt e Kuvendit, ku është kërkuar të diskutohet për temën e njejtë lidhur me deklaratën e avokatit z.Tomë Gashi për Reçakun. Unë nuk e kam pa të arsyeshme të mbajmë mbledhje të Jashtëzakonshme kur e kemi mundësinë që të diskutojmë në mbledhjen e

rregullt të Kuvendit e cila eshte e thirrun vetëm gjysëm ore më vonë dmth. në ora 09:00h të datës 04.07.2024. Unë e bëra propozimin që ta fusim këtë si një pikë shtesë, dhe në vazhdim e hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z.Besnik Seferi;** Përshëndetje, unë jamë “për” këtë rend dite, po ashtu jamë edhe për ta futur si pikë shtesë pikën që e propozoi Kryesuesi i Kuvendit “Diskutim për deklaratën e avokatit z.Tomë Gashi për Reçakun”. Unë po kërkoj që lidhur me këtë pikën shtesë që ka të bëj me masakrën e Reçakut mos të flasim politikisht, sepse është çshqje shumë e njeshme. E di që avokati z.Tomë Gashi ka kërkuar falje për këtë rast.

**z.Pérparim Ramusa;** Përshëndetje, pajtohem me pikat e propozuara të rendit të ditës po ashtu edhe me propozimin e Kryesuesit për pikën shtesë “Diskutim për deklaratën e avokatit z.Tomë Gashi për Reçakun”. Ne si Kuvend duhet të jemi të përkushtuar që të sjellim drejtësi për Reçakun. Në fund i urojë znj.Albana Podvorica dhe z.Besnik Seferit lindjen e fëmijëve të tyre.

**z.Reshat Mujota;** Përshëndetje, pajtoj me rendin e ditës, edhe me pikën shtesë të propozuar, por te kjo pikë kisha kërkuar që jo vetëm me diskutuar, por me nxjerrë një deklaartë ose ndonje konkluzion, që komuna nuk e pranon vetëm kërkim faljen, por që të distancohem nga deklarata e avokatit z.Tomë Gashit për Reçakun.

**z.Kadri Emin;** Përshëndetje, ne si grup parlamentar i LDK-AKR, pajtohemi plotësisht me rendin e ditës dhe po kërkojmë që ta miratojmë rendin e ditës dhe të vazhdojmë tutje.

**z.Rexhep Gashi;** Përshëndetje, pajtoj me pikat e rendit të ditës, edhe me pikën shtesë që e ka paraqitë PDK-ja.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi rendin e ditës, me pikën shtesë si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 26.06.2024,
2. Diskutim për deklaratën e avokatit z.Tomë Gashi për Reçakun,
3. Raporti i punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes për Janar-Qershorr 2024,
4. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e drejtorave të Institucioneve lokale arsimore,
5. Propozim-Vendim për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 100 euro për qdo muaj për familjet që strehojnë fëmijët pa përkujdesje prindërore.
6. Informatë nga KKSB për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershorr 2024,
7. Pyetje – Përgjigje.

### Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 26.06.2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Rexhep Gashi;** Faleminderit Kryesues, pikërisht te pika e parë e procesverbalit kam një diskutim të cilin mendoj që i ka ikur sekretarisë në procesin fizik, duke e njobur profesionalizmin e tina mendoj që është dashur të përfshihet ashtu siq ulet e diskutohet çdo asambleist apo siç jep raport çdo drejtor. Unë rrëth draftit te pika e dytë kam diskutuar rrëth qështjes së Kornizës Buxhetore dhe kam thënë Kështu: “ Te rruga Besim, situatë e shqetsume nuk kamë thënë, “rruga “Besim Sopa” nuk e dijmë se farë kuptimi ka por janë ndarë 10 mijë eurosh” por kam thënë “Te asfalltimi i rrugës, ndriqimit dhe trotuarit në Gjyrkovic, zgjerimi i rrugë “Besim Sopa” dislokimi i fushës sportive, rruga “Gjergjaj” me dhjetë mijë euro si do të bëhen këto projekte”, kam kërkuar sqarim, dhe jo siq ka mbetur në diskutim ky procesverbal. Kërkoj që ky diskutim të përmirësohet.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 18 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 29.05.2024.**

### Pika 2

Diskutim për deklaratën e avokatit z.Tomë Gashi për Reçakun (Pikë Shtesë)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Pérparim Ramusa;** Ne si PDK-ë, kemi thirrë mbledhje të jashtëzakonshme për deklaratën e Tomë Gashit për Reçakun, që ka folë të pa vërteta, për këtë është dashur me reaguar Kryetari, me thirrë mbledhje, dhe me reaguar. Këtë të pavërtetë duhet ta denojmë fuqimisht. Ne si Kuvendarë

jemi fuqishëm me banorët e Reçakut. Kërkojmë nga Tomë Gashi kërkim falje, ndryshe ne jemi me banorët edhe nëse kërkohet me bërë një padi ndaj tijë, ne e kemi obligim me i mbrojtë. Unë kërkoj 5 minuta pauzë me qëllim që anëtarët e grupeve parlamentare të ulemi dhe ta bëjmë një deklaratë.

**z.Reshat Mujota;** E kamë informatën se Kryesia e fshatit Reçak ka mbajtë mbledhje urgjente. Unë kërkoj që ne të ulemi bashkërisht dhe ta bëjmë një deklaratë për Tomë Gashin, i cili ka thënë se i akuzuar serb e ka bashkëshorten nga Reçaku e që kjo nuk është e vërtetë.

**z.Kadri Emini;** Përshëndetje, secila deklaratë e tillë që vjen nga kushdo ne jemi kundër dhe distancohemë prej sajë. Kemi informata se nga i njejti serb që ka deklaruar se bashkëshorten e ka nga fshati Reçak, e ka një aktakuzë dhe është i denuar. Mendoj se kjo çështje i takon nivelit nacional, dhe ecili subjekt duhet të distancohet nga deklarata të tilla. Ne e dimë se në Reçak më 15 janar 1999 është bërë masakër nga forcat e rregullta te Srbisë, dhe kjo tani më është e dëshmuar. Ne si subjekt i LDK-së distancohemë.

**z.Rexhep Gashi;** Kjo është çështje e ndjeshme. Është shumë shqetësuese se si organet qendrore nuk kanë bërë një reagim. Lavdi gjithë martirëve që u masakruan në Reçak. Ne si subjekt i LB-së i përkrahim banorët e Reçakut dhe të Kosovës, për sa i përket deklaratave të tilla të pa vërteta.

**z.Besnik Seferi;** Edhe ne si subjekt i LVV-së distancohemë, ndaj deklaratave të pa vërteta. Sa e di unë avokati Tomë Gashi e ka bërë një kërkim falje lidhur me deklarimet e tija. PDK-ja e ka kërkuar një sancë të jashtëzakonshme, por ne e pamë të arsyeshme që këtë çështje ta diskutojmë në mbledhje të rregullt e cila ka qenë e thirrun më heret vetëm gjysëm ore më vonë, prandaj ne kemi menduar se më mirë është që me e futë si pikë shtesë e kësaj mbledhje. Ne sigurisht që distancohemë dhe e denojmë secilën deklaratë e cila prekë ose cënon të vërtetën për masakrën e Reçakut.

**z.Përparim Ramusa;** I dëgjova fjalimet e kolegëve, unë mendoj se nuk mjaftojnë vetëm deklarimet tona që distancohemë. Ne si PDK-ë propozojmë që ta përpilojmë një deklaratë, me të cilën e demantojmë deklaratën e tijë, të dhënë në TV në emisionin “Debat Plus” lidhur me Reçakun, sepse konsiderojmë se ajo deklaratë është e pa vërtetë e dëmshme dhe është shpifje.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Unë thash në fillim që të jemi të kujdeshëm në fjalimt tona, për mos me përdorë këtë rast dhe me e politizuar, sepse është tejet e ndjeshme. Unë si Kryesues i Kuvendit e kamë përcjellë me vëmendje gjithë situatën, kamë folë me Kryesinë e Fshatit Reçak, dhe unë e kamë menduar edhe çështjen e mbledhjes së jashtëzakonshme, të cilën poçëse kishin kërkuar një gjë të tillë Kryesia e Fshatit Reçak, sigurisht që do ta thirrnim, mirëpo një kërkësë të tillë nuk e kemi nga Kryesia e fashtit. Sa i përket ftesës ligjore të PDK-së për seancë të jashtëzakonshme, për datën 04.07.2024 në ora 8:30h që faktikisht është thirrun vetëm gjysëm ore më heret se mbledhja e rregullt, ne e kemi pa të arsyeshme që këtë çështje ta fusim si pikë shtesë të rendit të ditës dhe të diskutojmë në mbledhjen e rregullt të Kuvendit e thirrun për datën 04.07.2024 në ora 9:00h. Unë nuk dua që ta mbrojë askend, por avokati Tomë Gashi është avokat mbrojtës i rastit të Masakrës së Reçakut, kështu që mendoj se kjo është çështje ndërkombëtare për faktin se ky avokat ka ngritur padi ndaj presidentit të Serbisë pikërisht për mohimin e Masakrës së Reçakut.

**z.Rahman Jakupi;** Përshëndetje për qytetarët dhe kolegët, ne si PDK-ë e kemi thirrë një mbledhje të jashtëzakonshme për këtë çështje. Po të ishte PDK-ja në pushtet, sot këtu do të bëheshin protesta dhe do të gjuheshin gurë. Në nenin 6 të Rregullores së punës së Kuvendit, thuhet që Kryesuesi duhet me e thirrë mbledhjen e Kuvendit. Nuk është i vetmi Tomë Gashi që ka dhënë deklaratë të tilla ka edhe të tjera. Ky e ka marrë vetëm një rast të Reçakut e që ka dështuar. Në vazhdim unë do ta levoj tekstin e pregaditur të deklaratës (Në vazhdim lexoi deklaratën e tijë). Kjo është një deklaratë me 3 paragrafë, dhe unë nuk po e di se çka po ju pengon me miratuar një deklaratë të tillë. Ky zotriu ka kërkuar falje, e kemi pa, por Kryesia e fshatit Reçak po kërkon që kërkimfalja të bëhet po në të njejin emision “Debat Plus” për shkak të shikueshmërisë që ka ky emision.

**z.Reshat Mujota;** Ne nuk jemi kundër avokatit por jemi kundër deklaratës së tijë për Reçakun. Unë po kërkoj pauzë për ta përpiluar një deklaratë në emër të Kuvendit.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Përshëndetje për të gjithë, sidomos për banorët e fshatit Reçak, një gjë duhet të gjithë ta kemi të njojur mirë, se kjo është çështje tejet e ndjeshme, dhe duhet ti mendojmë mirë fjalët kur i flasim. U tha se ne nuk ishim të shqetësuar për këtë rast, unë mund të ju them me

bindje të plotë se shqetësimi i banorëve të fshatit Reçak, ishte edhe i yni, për një deklaratë të tillë. Prandaj lidhur me rastin unë jamë interesuar dhe kamë marrë masa duke ra në kontakt menjëherë edhe me Kryesinë e fshatit Reçak edhe me avokatin Tomë Gashi, të cilin e kam pyetur për rastin, unë nuk dua ta bëj avokatin e askujt, por po e sqaroj për banorët e fshatit Reçak, se ai më ka thënë se: “ Unë që nga viti 2021, jam duke e mbrojtë Reçakun me autorizimin e banorëve të fshatit Reçak, dhe se ky kriminel ka shpifur në seancën gjyqësore ku i ka thënë Gjykatës se “Ju nuk mund të më denoni sepse unë jam dhëndërr i Reçakut e kam gruan Shqiptare nga Reqaku dhe atje unë hyjë e dal kur dua” ndërkaq që ai e ka gruan nga Prizreni dhe nuk ka lidhje me Reçakun”. Ne si Komunë nuk kemi asnje kërkesë, as nga Kryetari e as nga Kryesia e fshatit Reqak për ta thirrë një seancë të Kuvendit apo diçka tjeter, ndryshe ne do ti përgjigjemi secilës kërkes që vjen nga banorët e Reçakut. Avokatin siç e keni dëgjuar edhe ju ka bërë kërkimfalje për këtë lapsus në afekt. Dihet se avokati Tomë Gashi është i dëshmuar për mbrojtjen e tijë për Reçakun ku krimineli Zoran Stanojeviq është denuar me 15 vjet burg, me argumentet që i ka ofruar avokati Tomë Gashi. Unë po kërkoj që mos të hapim plagë të reja për familjet e Reçakut sepse vetë kjo ngjarje është shumë e ndjeshme dhe po aq e rëndësishme e cila ka bërë kthesë historike për Kosovën, dhe kam frikën se me deklarimet tonë mund të bëjmë më shumë dëm se sa të sjellim dobi, për këtë arsy unë u bëj thirrje që secili prej neve por edhe qofshin ata gazetarë ose qytetarë të kenë kujdes në prononcimet e tyre për shkak të ndjeshërisë dhe rëndësisë.

**z.Rrahman Jakupi;** Replikë me Kryetarin, ju sa e demantuat vetveten, sepse nuk jeni në gjendje me thirrë një mbledhje të jashtëzakonshme, dhe as me e përkrahë deklaratën. Zgjedhjet po vijnë, dhe ju do të shkonit në shtëpi. Sot për këtë rast e keni luajtë krejt rolin e avokatit. Kërkoj nga kolegët që ta hudhim në votim dhe ta votojmë.

**z.Reshat Mujota;** Pikërisht nga ju kjo qështje u bë politike,. Kryetari tha se kam biseduar me Tomë Gashin, pse pra atëher vetëm nuk e bëre një deklaratë? Pyetja e dytë, a je i ftuar nga Kryesia e fshatit Reçak? E treta pse mos me u përpilu një deklaratë kundra fjalimit përkatësisht kundra shpifjes që e ka thënë ai? Tjetra a mjafton me thënë më fal? Pse Komuna e Shtimes nuk e ka një reagim në faqen e sajë zyrtare? Unë kërkoj që me e votuar një deklaratë.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Unë fizikisht nuk kam qenë i ftuar nga kryesia e fshatit Reqak, por unë kamë qenë vazhdimisht në kontakt me Kryesinë e fshatit Reçak. Unë edhe një herë po them se si Kryetarë i Komuës së Shtimes, distancohem nga ajo deklaratë. Pas kërkim faljes që ka ndodhur Kryesia e fshatit mendoj se nuk e kanë pa të udhës me vazhdu më shumë, mirëpo siç e thash nëse ka një kërkesë nga fshati ne do ti përgjigjemi.

**z.Përparim Ramusa;** Ishe shumë i paqartë Kryetarë, ne nuk të akuzuam ty, por Reshati e tha shumë mirë, pse nuk jeni dalë me një prononcim. Lëndimi ka ndodhur. Ne po kërkojmë me e demantuar një deklaratë të tillë, kur ai vetë e ka pranuar, e pse na mos me e demantuar.

**znj.Adelina Beqaj;** Përshëndetje, po flasim për një çshtje të ndjeshme, që ka ndikuar edhe në arenën ndërkombëtare. Ata kanë dhimbje më shumë se sa ne këtu ulur në karrige. Ti Kryetar sa po e demnatove vetë, kështu që edhe ti duhet me na u bashkëngjitur në deklaratë.

**z.Besnik Seferi;** Unë po e citoj avokatin Tomë Gashi “Në vitin 2021 unë kamë ngritur aktakuzë ndaj kriminelit Zoran Stojanoviq. Ajo deklaratë është e Zoran Stojanoviqit e jo pohim i imi” Pastaj ka thënë në TV se bashkëshorten e ka shqiptare nga Reqaku, por në fakt ajo nuk është fare nga Reçaku. Po ashtu ka thënë se në vitin 2019 ose 20 kam bërë Aktakuzë kundër presidentit të Serbisë Vuçiç. Po kërkoj një pauzë prej 5 minutave që të dakordohemi bashkërisht se si do të veprojmë tutje. Zoteri Jakupi tha se ju nuk e keni përgatitur deklaratën sepse ju nuk dini, ky deklarim i tijë është absurd, unë i them ati se ne dimë edhe të punojmë edhe të bëjmë deklarata.

**z.Lumni Amrushi;** Përshëndetje, mirë filloj seanca, por në vazhdim po devijohet. Ju si LVV-ë mundeni me bërë deklarata, por ju ka ikur një deklaratë në vitin 2008. Unë po flas vetëm nga ato që kanë qenë publike. Meqenëse Kryetari i fshatit paska qenë në kontakt me ju Kryetar, atëherë është dashur me thirrë mbledhjen e kryesisë së fshatit para se ai me kërkuar falje. Sa i përket deklaratës idea ka qenë që ta bëjmë bashkërisht, por meqenëse Kryetari si zakonisht që e nxjerrë nga binarët mbledhjen e Kuvendit, neve po na nxitë me diskutuar. Unë po dal jashtë dhe bëne një deklaratë, unë do të vijë dhe do ta votoj pa e lexuar. Ate që po kërkoj është që të jemi bashkë.

**z.Besnik Seferi;** Unë nuk ju akuzova vetëm juve por edhe njerzit e mi. Personazhi këtu është avokati Tomë Gashi, kështu që i nderuar unë nuk e mbrojë askend, por vetëm vetveten. Pas

diskutimit të Lumni Amrushit po e vërtetoj se këtë çështje e keni ngritur vetëm për arsyen puro politike, prandaj atë pesë minutshin që e kërkova, unë tash më nuk e kërkoi por do të vazhdojmë me mbledhjen. Mos na e lëndoni karakterin, unë nuk lejoj me më fyer brenda këtijë Kuvendi.

**z.Rexhep Gashi;** I dëgjova diskutimet për mospolizim, e pikërisht ata po e bëjnë të kundërtën. Sa i përket deklaratës mua më intereson se kush e nxjerrë deklaratën. Unë kamë me kontribuar në këtë deklaratë. Të lutem mos më pengo gjatë diskutimit Besnik. Unë e përkrahu deklaratën e secilit subjekt, sepse duhet të jemi kundër një deklarate të tillë. Unë po kërkoj pesë minuta pauzë që ta përpilojmë deklaratën.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Duhet ta dimë se e kemi edhe rregulloren e punës së kuvendit të cilën duhet ta respektojmë, e cila thotë “Asnjë nga pikat e propozuara të rendit të ditës nuk do të shtronë për diskutim në mbledhje pa miratimin e Kuvendit” Ne e miratuam rendin e ditës me pikën shtesë ku tham “Diskutim për deklaratën e avokatit z.Tomë Gashi, për Reçakun” e jo “Deklaratë”. Kryetari e tha, nëse kemi kërkesë nga Kryesia e fshatit Reçak, ne do ta qojmë përrpara.

**z.Reshat Mujota;** Unë kërkova që kjo të jetë institucionale e jo partiake, prandaj edhe kërkova pesë minuta pauzë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Po e them prap për fshatin Reçak, nëse Kryesia kërkon ne do ti dalim përballë, edhe jemi përkrah tyre, qoftë edhe për me thirrë seancë të Kuvendit.

### Pika 3

#### Raporti i punës së Ekzekutivit të Komunës së Shtimes për Janar-Qershori 2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Tash po konstatoj se në këtë pikë të rëndësishme që ka të bëj me raportin e punës të ekzekutivit të Komunës, anëtarët e Kuvendit nga opozita e lëshojnë mbledhjen pa asnjë sqarim dhe nuk marrin pjesë në diskutimin e kësaj pike, sikur që nuk kanë marrë pjesë në debatet publike që janë organizuar për Korrizen Afatmesme Buxhetore.

Kryetari z.Qemajl Aliu, do ta bëj prezantimin e raportit të punës gjashtë mujore të ekzekutivit përmes video-projektorit ashtu siq e ka paraqitur edhe para qytetarëve. Ju njoftoj se për këtë pikë e kemi edhe miratimin nga Komiteti për Politikë dhe Financa si dhe Komiteti për Komunitete. Fjalën e ka Kryetari për prezantimin e kësaj pike.

**Kryetari, z.Qemajl Aliu;** Ne po punojmë pa rreshtur, dhe si rezultat e kemi fituar edhe grantin e performancës në mesin e pesë komunave më të mira të Kosovës. Me këtë grant i kemi fituar edhe 395.000€ më shumë të cilat do të ndikojnë drejtësore përmirsimin e jetës te banorët e Komunës tonë. Pagesa e tatimit në pronë në nivelin më të lartë e tregon edhe besimin e qytetarëve në qeverisjen tonë. Buxheti prej 10.5 milionëve duke i shtuar kësaj edhe grantin e performancës të shpenzuar në mënyrë të barabartë dhe transparente edhe më shumë e forcon besimin te qeverisja e jonë. Siq e dini buxheti i vitit 2023 është shpenzuar maksimalisht me 96 %. Sa i përket Reçakut ne nuk po bëjmë politika por po punojmë Memorialin e masakrës së Reçakut ne po e bëjmë projekt nacional menjëher pas projektit të familjes Jashari në Prekaz. Tash më kjo është në agjendën shtetërore falë përkushtimit dhe insistimit tonë që e kemi ngritë dhe shty përrpara. Vendimi për subvencionimin e Nënave Lehona, ku këtë do ta rishqyrtojmë për ta ngritur për çdo vit. Për vlerat e luftës është dashur me kaluar 24 vite për arritjen e shumë projekteve, poashtu edhe lirimin nga taksa për automjete të të gjitha kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së. Pastaj lirim i prindërve për sezonin veror nga pagesa për rexhistrimin e fëmijëve në Çerdhen “Albiona Asllani”. Funksionalizimi i qendrës së inovacionit. 5 milion janë planifikuar për trajtimin e shratatit të lumit Shtimjanja. Përfundimi i projektit të Unazës së vogël i premtuar e cila ka kushtuar rrith 382.000 €. Rregullimi i podiumit të stadionit të qytetit. Po punohet për asfalltimin e rrugës te Zona Ekonomike në Gllavicë me shumën prej 100.000€. Asfalltimi i rrugës deri te Kulla e Lirisë në Reçak. Asfalltimi i rrugës Pjetërshticë – Dugë, që e prekë edhe teritorin e komunës së Suharekës. Asfalltimi i rrugës “12 Qershori”. Në fshatin Vojnovc janë asfaltuar disa rrugica. Janë ndërtuar shkallët te Gjimnazi “Naim Frashëri”. Çerdhja në Godanc pritet shumë shpejt të promovohet, por edhe në Petrovë do të fillojë shumë shpejt. Pastaj objekti i Arkivës dhe Bibliotekës. Bursat për studentë janë rritur në 100 bursa. Vaksina e shumëpritur për kancerin e qafës së mitrës. Subvencionimi i serrave në sektorin e bujqësisë. Subvencionimet në fushën e sportit. Ringjallja e Shjtëpisë së Kulturës janë promovuar tri premiera. Laboratori në QKMF-ë 24 orë. QMF-të në

Godanc dhe se shpejti në Petrovë. Parqe 4 dhe do të bëjmë për secilin vendbanim nga një. Kemi filluar me 7 kabina për vendalje të Autobusëve dhe do të vazhdojmë deri sa të përfundojë i téri. Promovimi i projektit të Observatorit ka bërë bujë në opinion në vlerën e 310.000 €. Do të vazhdojmë me projekte të mira edhe më tutje, flm. Për vëmendjen.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Reshat Mujota;** Faleminderit për raportin. Kah i pasha fotot në Video-projektor u knaqsha besoni. E kam lexuar dokumentin, dhe i kam pa se shumicën e premtiveve që i ka dhënë Kryetari nuk e di se a do të përmbyllen. Me fillu por unë mendoj se nuk kanë me mujt me perfunduar as edhe pas kalimit të mandatit.

Pyetja e parë, a do të përfundon Memoriali i Reçakut këtë vit? U tha te pjesa e Inovacionit si pjesë funksionale, por kur e marr këtë raport, e tregon një letër të shkruar, që mua do të më vinte marre me pru në Kuvend, sepse fotografat që i pashë kjo na del e demantueme. Te bujqit në 2024 nuk janë subvencionuar me farë por me pare, ku kanë përfituar 280 fermer dhe vlera na del mbi 30 mijë euro, secili fermer ka paguar nga 1 euro taksë komunale, dhe nëse e shikojmë në tabelë kemi këtu një diskrepancë, që duhet të sçarohet. Kur e merr e analizon mirë i bjen që i keni ndihmuar nga 7 euro për bujkun, dhe kjo nuk është krenari. Këtu unë nuk po e shoh Kolektorin që e kemi diskutuar shumë herë. Pytja tjetër është a do të përfundon shtrati i Lumin këtë mandat, sepse ka qenë premtim? U tha për Unazën e vogël dhe Tregun, por Tregu nuk është përfunduar dhe unë mendoj se nuk do të mund të funksionalizohet. Te subvencionimi i Nënave Lehona, le të bëhet me kod të përhershëm buxhetor nëse është mundësia.

**z.Muhamed Ademaj;** Përvendetje, e falënderoj Kryetarin për raportin. E vlerësoj angazhimin e Kryetarit në të gjitha fushat institucionale. Projekte janë duke u realizuar sipas planifikimit, kështu që ne e mbështesim këtë raport.

**znj.Adelina Beqaj;** E dëgjova Kryetarin, dhe po del ashtu qysh kam thënë më heret se projektet i keni në hava. Inovacionin ta ka lanë Naim Ismajli. Cili është roli i infrastrukturës te Kompleksi Memorial? Te Parku Teknologjik nuk po shihet asgjë. Ke premtuar zona të reja ekonomike e nuk ka asgjë. Shkallët po te Shkolla por ndriqim nuk kanë. Çka po ndodhë me Bibliotekën aktualisht? A ke bërë QMF-ë të re najkun? Observatori ka qenë mision i joni. Vaksinat janë në nivel të krejt Kosovës. Ti nuk ke qu Specialist në QKMF-ë por i ke larguar nga QKMF-ja me shantazhet e juaja. Për Petrovë në Kuvend e kanë Kryesuesin dhe dy asambleista. Me stacione kurgjë nuk keni bërë. Asnjë projekt ti Asllan e as Muhameti nuk e keni bërë.

**z.Përparim Ramusa:** E falënderoj Kryetarin për fotografitë. Kryetar ky raport është i propagandës. Ku e ki rrugën e Topillës 2022-2023-2024? Ku i ki investimet te lumi Shtimjanja? Ku e ki zhvendosjen e Entit Special? Ku e ki QKMF-në? Kryetari i Ferizajit e ka kryer ndërtimin e vrazhdë. Kemi furnizim me tepija, pastaj kemi 4.400 euro shërbime te zyra e Kryetarit. Qytetarë të nderuar shkonit në rrugën Davidovc e shikonit kockat se si janë vendosur. Te të hyrat vetanake janë planifikuar më pak se sa në vitin paraprak, ku ka kështu more. Më ka ardhur marre kur e kam lexuar raportin e drejtorisë së Inovacionit, qka është shkruar në raport, shkruan për dhënien e Llaptopëve.

**z.Rexhep Gashi;** Disa banorë të Reçakut më kanë reaguar, pikërisht nga jashtë rendi i ditës. Kur e pashë që e ndryshuat pikën e rendit të ditës nga raporti financiar në raportin e punës së ekzekutivit, i pashë disa fotografat për punën që është bërë. Te drejtoria e Inovacionit, që e kam përkrahur Kryetarin me vetëdije, pikërisht për drejtorinë e Inovacionit, far rëndësije ka kjo drejtori kur flitet për Llaptop. Në raport i pashë 11 kontrata për punën shtesë, kjo bëhet kur keq-planifikohet. Nuk shoh transparencë te menagjerat e kontratave. Në raport duhet të cekën edhe dështimet, sikurse që janë në arsim e shëndetësi.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Propozoj të shkojmë në pauzën e drekës në ora 12:00h dhe kthehemë në seancë për ta vazhduar në ora 13:00h

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Po vazhdojmë seancën me pikën e njejtë, në ora 13:26h.

**z.Rahman Jakupi;** Në fillim kur e pashë pikën e rendit të ditës raport financiar e pastaj u ndryshua në raport i punës së ekzekutivit, pyetja është çka do të ndodhë me raportin financiar, a po i bjan që është shkelje e Ligjit për financat publike, dhe LVL-së.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Ne e kemi të miratuar edhe Orarin e mbledhjeve të Kuvendit, dhe sipas këtijë orari për muajin Korrik e kemi të caktuar më datën 4 Korrik, kështu që raporti finansiar nuk ka mundur të përgatitet për kaq kohë të shkurtë, kështu që raporti finansiar do të vijë në Kuvend në seancën e radhës.

**z.Asllan Beqaj;** Përshëndetje, po e filloj me lëvdata sepse kjo qeverisje po kryen punë të mira për qytetarët në të gjitha sektorët, dhe kjo po vërtetohet edhe me raportin e performancës së mirë të Komunës së Shtimes, ku jemi përfitues të grantit qeveritar si njëra ndër 5 Komunat më të mira. Kemi projekte në fushën e Bujqësisë, ku janë të përfshira të gjitha fshatrat. Në infrastrukturë që u fol për fshatin Petrovë këta e dinë mirë, për asfalltimin e rrugës “Mehdi Korrani” është përfunduar Ura, Parku jo sikurse parqet e mëparshme me nga një karrikë e disa kocka. Tash do të fillojë edhe ndërtimi i ankesit të shkollës në Petrovë. Ka pas rrezik gjithmonë nga transporti i rëndë që është zhvilluar e tash nuk do të ketë më. Çerdha do të filloj shumë shpejt, kështu që banorët e fshatit Petrovë e kanë ditur shumë mirë se kujt me ja dhënë votën. Unë përkundër të tjerëve nuk kam pas kohë për me u marrë me interesa vetanake e me i ndrru partitë. Vendpritjet për autobus po bëhen dhe do të vazhdojnë në të gjitha fshatrat. Ndërtimin e Lapidarit në Petrovë unë e kamë përkrahur konkretisht sa kam mundur, mirëpo unë nuk vrapij aty për me nxanë një ulëse përparrë sikurse koleget nga PDK-ja, sepse unë nuk jamë i tillë. Për lumin janë ndarë 5.5 milion euro, dhe siq e dimë të gjithë shtrati i lumit gjithandjej është ngushtuar shumë, por ky do të rregullohet më në fund.

**z.Adelina Beqaj;** Kolegu tha banorët kanë ditur kend me e votuar, unë për herën e dytë jam dhe kamë ardhur fuqishëm. Urën e kam propozuar unë, e ki dëshmitarë Bujar Feratin. Kjo ishte ideja ime, sepse unë ty nuk do ti jap idetë e mijë. Sa i përket ndrrimit të partive politike, unë nuk kam pasur lider, dhe për këtë arsyë unë kam ardhur te Partija Demokratike, si parti serioze.

**z.Asllan Beqaj;** Unë nuk e kam hallin e votave sikurse parafolsja, unë e kamë hallin se si me u reasliguar më shpejtë dhe më mirë projektet që janë në favor të banorëve siç është projekti i pritur kaherë i ndërtimit të Çerdhes për fëmijë, si dhe projekteve të tjera shumë të rëndësishme, për Petrovën. Urën nuk e ke menduar kurrë, ky është propozim i Kryetarit Aliu.

**z.Muhamed Ademaj;** Adelina po shihet që e ka krijuar një fobi ndaj meje dhe Asllanit, kjo ka bërë akuza edhe ndaj vajzës sime, sa ishte në punë këtu në Komunë. Në Petrovë është duke u punuar me të madhe siç janë ndriçimi, pastaj kanalizimi në lagjen time “Ademaj”. Unë mendoj se kjo është mirë me i votuar projektet sepse është bijë e Petrovës.

**z.Lumni Amrushi;** E pashë një raport 6 mujor, i cili po i diskriminon disa vendbanime sikurse janë Petrova, Pjetërshtica etj. ndërsa e përkrahin Godancin, nuk duhet me u pa këto diskriminime. Çka u punu në fshatin Pjetërshticë, e pres një përgjigje prej juve? Salla e sportit pranë shkollës fillore. Qe 3 vjet mandat nuk janë përfunduar shumë projekte, ku ka pasë nevojë që disa projekte me u kry, por hiq më mirë nuk është as në vendbanimet tjera.

**z.Zejnije Veliu;** Përshëndetje, po flas për raportin e kryerjes së punëve nga ekzekutivi, siq e dini ekzekutivi është i obliguar që punët ti kryej ashtu siç janë planifikuar. E mira është se projektet po realizohen në të gjitha fushat dhe vendbanimet e komunës në një mënyrë gjithëpërfshirëse, qoftë në arsim, shëndetësi, bujqësi etj. duhet përmend projektin e digitalizimit pastaj projektin e nxemjes me biomasë etj. Disa e përmenden këtu se si Petrova, e Pjetërshtica paskan ngecur mbrapa me projekte, këta i kisha sygjeruar që të kthehen pak e të shikojnë nga fahti Gllavicë, është mirë të mendohet për të gjitha vendbanimet njësoj.

**z.Reshat Mujota;** I shtrova pyetjet për Kryetarin, e që tani nuk është prezent. Tash i presim përgjigjet nga drejtorat. U fol këtu për projekte lokaliste, pyetja ime është për të gjithë, sepse edhe te realizimi i projekteve ka gabime marramendëse, shikoni njëher se kush janë mbikqyrsat e projekteve, kështu kemi me pas gjithmonë probleme. Përgjigjet i dua adekuate dhe konkrete. Në arsim kanë humbur shumë orë mësimi dhe nuk ka performancë.

**z.Përparim Ramusa;** Unë po diskutoj për arsim, pasi foli zonja Zejnije. Çfarë suksesi është kur sivjet e keni humbur 8000 orë mësimi për gjysëmvjetorin, jeni detyruar me mbajtë orë plotësuese.

**z.Zejnije Veliu;** Unë nuk do të bëj replikë, për hirë të qytetarëve.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ju njoftoj se Kryetari është në Prishtinë, dhe pyetjet do ti merrni nga drejtorat.

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE;** Përshëndetje, pyetja për zonën ekonomike në Gllavicë, vlera e investimit vetëm brenda është rrith 100.000 euro. Tash po realizohet projekti i asfaltimit të rrugës nga zona deri te rruga kryesore Shtime-Ferizaj me një shumë prej 77.000 eurove, vitin e kaluar kanë qenë 40.000 euro. Sa i përket projektit të ngrrotores me Biomasë, ne e kemi gjetur një projekt ku ka qenë i përfshirë sipas matjes së fizibilitetit vetëm objekti i Komunës dhe objekte e institucioneve publike, në vlerën prej 180.000 eurove, mirëpo tani pritet që në këtë projekt të kenë qasje edhe një numër i banorëve, ku vlera e projektit ka shkuar në 3 milion euro, dhe është në Qeverinë e Kosovës.

**z.Gojart Bajrami, drejtor i DBPZHR;** Përshëndetje, sa i përket pyetjes së Reshat Mujota, Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, e ka paraparë të ndihmoj bujqit në formën e pagesave direkte me një shtrirje të përgjithshme. Vlera e këtij subvencionimi është 30,675.40 Euro.

**z.Bujar Ferati, Zyra e Tatimit në Pronë;** Përshëndetje, Te pyetja e zotri Mujota, nuk qenka këtu por ai tha, te subvencionimi i Nënave Lehona, le të bëhet një kod i përhershëm buxhetor nëse ekziaton mundësia. Kodet dhe Kategoritë ekonomike ekzistojnë, dhe nuk ka nevojë për kode të reja, sepse ato janë. Te Përparimi që tha se të hyrat vetanake janë planifikuar më pak se sa në vitin paraprak, kufiri i të hyrave caktohet me Qerkoren Buxhetore dhe aprovojen në këtë Kuvend. Janë më të vogla edhe përfaktin e vendimit që e keni marrë përfaljen e 100 eurove te tatimi në pronë. Mbetet që pas aprovimit të Buxhetit ti përvishemi punës për realizimin e projekteve.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Përshëndetje, projekti i rrugës "Viliam Voker" është në kuadër të Ministrisë. Është duke u bërë një test i kanalizimit për pjerrtësinë që e ka. Sa i përket Lumin sa e di unë nuk ka ndonjë ankesë dhe do të nënshkruhet kontrata. Sa i përket projektit të QKMF-së dhe Entit Special kjo është ende në procedurën e hartimit të projektit detal. Ndërtimin e rrugës "Mehdi Korrani" në Petrovë në vlerën prej 500.000?? euro që kalon mbi atë urën e famshme, e kemi propozuar të gjithë bashkërisht. Projekti për ndërtimin e rrugës Luzhak-Reçak-Rancë në vlerë prej 500.000?? euro pritet të fillojë në muajin Gusht.

**z.nj.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA;** Përshëndetje, përfallë sportive në Pjetërshticë kamë shënë përgjigje, salla do të funksionalizohet. Sa i përket rrethojave e di që ka nevojë por duke i marrë parasysh prioritetet e realizimit të projekteve na del se kemi prioritete më të rëndësishme sikurse është rasti që kemi problem me pullazet që pikin ujë brenda, në ndërtimin e të cilave nuk janë respektuar normat e ndërtimit. Nuk po përmendet projekti i ndërtimit të shkallëve te Gjimnazi, një projekt i jashtëzakonshëm. Duhet me u përmendë edhe projektet e mira. Zoti Ramusa vazhdon me i përmendë orët e humbura, e nuk e përmend faktin që përfkohështë vit i kemi renovuar 5 shkolla, ndërsa në vitin e kaluar i kemi renovuar 8 shkolla, ndërsa në këtë mandat i kemi renovuar gjithsej 15 shkolla, kjo është një punë e madhe që është bërë.

**z.Përparim Ramusa;** Orë të mësimit i keni humbur 8300. Në Pjetërshticë, e keni marrë shkollën, e ti nuk po mundesh me ba një rrethojë. Qytetarët e dinë se sa keni investuar.

**z.nj.Adelina Beqaj;** Drejtoresha vjen prej fshatit Vojnovc, dhe kjo po thot hajde PDK-ë jepni raport në Kuvend, ti nuk kishte aftësi me udhëheqë, dy shkolla nuk je në gjendje me i renovu, kështu që si drejtoreshë je e dështuar.

**z.Besnik Seferi;** Tani këto akuza nga ju përfshin dy vjetë e gjysëm qeverisje po më duken pak si shumë nga ana juaj. Pse po hapet e kalumja, unë nga ekzekutivi kam kërkuar përfshin e Lagjes së Pajtimit irregullisht dhe kurrë nuk është bërë asgjë, edhe përkundër faktit se Lagja e Pajtimit është e dyta në Komunë përkah numri i banorëve. Ju kurrë nuk e keni kurajon me thënë këtu një her se e keni bërë mirë një projekt. Unë po them përkundër ndërtimit të disa parqeve, është në mungesë të madhe mirëmbajtja e këtyre parqeve. Unë jam me mandat te dytë dhe që shumë vite unë nuk kam parë një raport të tillë nga Kryetari sikurse ky i Kryetarit Aliu.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 16 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 04.07.2024 me 10 vota "Për" me 6 vota "Kundër" dhe me 0 vota "Abstenim" miratoi, Raportin gjashtë mujor të punës së ekzekutivit të Komunës së Shtimes përfshin 2024.

## Pika

### Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e dreitorave të Institucioneve lokale arsimore

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha znj. Yllkë Fejzullahu. znj. Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA; Sipas Ligjit ne jemi të obliguar që ta prezantojmë në Kuvend propozimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e dreitorave të Institucioneve lokale arsimore në Komunën e Shtimes. Komisioni realisht ka gjithsej 3 anëtarë por njëri është përfaqësues nga niveli qendror. Ju e keni marrë propozimin e DKA-së me kohë në formë të shkruar, kandidatët e propozuar janë z.Rexhep Hasani – Drejtor në SHMU “Emin Duraku” në Shtime, dhe znj.Feride Qorrolli-Lubishtani, mësimdhënëse në Univerzitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, e përfaqësuar në Komision si eksperte e pavarur nga fusha e Arsimit. Ju ftoj që ta miratoni këtë vendim.

**znj.Adelina Beqaj;** Drejtoresha po i bënë punët shabillon, siç e thashë më parë.

**z.Rahman Jakupi;** Unë mendoj se në KPF-ë nuk e kanë kupuar mirë, sepse ekziston një Udhëzim Administrativ, mbi bazën e të cilit nuk është prezantuar në KPF-ë e që anëtarët kanë ra në lajthitje. Unë po ju tregoj se keni me votuar kundërligjshëm. Udhëzimi Administrativ Nr.106/2020 thot që Drejtoria e Arsimit duhet me bërë testimin e performancës. Këta drejtorë janë të diskriminuar vazhdimisht, ka marrë vërejtje njëra nga drejtorët që është vonuar 5 minuta. Tash keni me marrë një proces të kundërligjshëm, sepse nuk ka ndodhë një proces i vlerësimit të performancës.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Ne si KPF-ë e kemi pas dokumentin përpara. Ka pas një keqkuptim sepse kemi menduar për tre anëtarë e realisht kanë qenë dy anëtarë të Komisionit.

**z.Besnik Seferi;** Unë mendoj se nuk ka nevojë që të diskutohet kaq gjatë për çdo vit, propozimin e kemi përpara e miratojmë dhe vazhdojmë tutje.

**z.Muhamed Ademaj;** Këta janë bërë shumë eksperta të gjitha fushave, diskutojnë ende para se me i dhënë propozimet. Ka këtu që i kanë të punësuar familjarët në arsim. Nuk është gjendja e keqe në arsim ashtu qysh po thuhet këtu nga opozita. Mendoj se nuk ka gjë të keqe për mësimin plotësues. Ne i përkrahim këto propozime që kanë ardhur nga drejtoria e arsimit.

**z.Yllkë Fejzullahu, drejtoreshë e DKA;** Ky Kuvend ka degraduar nga opozita, dhe kështu qysh po reagoni vetëm sa po e vërtetoni atë që unë po e them. Kryesues, duhet me reaguar përgjuhën jo parlamentare që po e përdorë opozita. Ky propozim i yni vjen në Kuvend për miratim për çdo vit sepse e kemi obligim ligjor.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 16 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 04.07.2024 me 10 vota “Për” me 6 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” miratoi, Vendimin për formimin e Komisionit përvlerësimin e kandidatëve që kanë konkurruar në të gjitha Konkurset që do të shpalen nga DKA-ja për postin e drejtorit, përkatësisht zëvendës-drejtorit, në Institucionet edukativ-arsimore të komunës së Shtimes, me mandat një (1) vjeçar deri më 04.07.2025, si vijon:

**z.Rexhep Hasani – Drejtor në SHMU “Emin Duraku” në Shtime, znj.Feride Qorrolli-Lubishtani, mësimdhënëse në Univerzitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, e përfaqësuar në Komision si eksperte e pavarur nga fusha e Arsimit.**

## Pika 5

### Propozim-Vendim për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 100 euro për qdo muaj përfamiljet që strehojnë fëmijët pa përkujdesje prindërore

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Përparim Ramusa:** U dakordua që kjo pikë është e ndjeshme, dhe në KPF-ë kemi thënë që me shiqu mundësinë financiare për me e rritë shumën në 150 euro. Ju keni pas pare 4000 euro për me e fotografuar Kryetarin, e këtu nuk po keni, unë edhe ashtu do ta votoj.

**znj.Adelina Beqaj;** Me krejt respektin tim, unë e përkrahu këtë vendim për këto gra. Unë kamë biseduar me to, nuk është se nuk janë mundësitë financiare, unë tanë do ta përkrahu këtë shumë, por me miratimin e buxhetit unë do të kërkoj që kjo shumë me u rritë.

**z.Besnik Seferi;** Fillimisht duhet ditur se kjo është një nismë e mirë, për ti ndihmuar sado pak kësaj kategorie. Ndërsa në të ardhmen do të shikohet mundësia përritje.

**z.Muhamed Ademaj;** Ne si grup parlamentar LDK-AKR-ë, e vlerësojmë lartë punën e këtyre grave për strehimin e këtyre fëmijëve pa prindër ose të braktisur nga prindërit, dhe ne do ta përkrahim këtë vendim.

**znj.Zejnije Veliu;** Siç e dimë tani për tani në Komunën tonë janë tri familje që kanë marrë fëmijë pa përkujdesje prindërore, të cilat ne i përkrahim ato dhe e përkrahim nismën që ti mbështesim me një shumë sado simbolike, mirëpo kjo duhet të vazhdojë të rritet me rritjen e Buxhetit.

**znej.Saniye Sadiku;** Përshëndetje, e përgëzoj Kryetarin Aliu, fillimisht për iniciativën për ti ndihmuar këtë kategori të familjeve që pranojnë ti rrisin fëmijët që kanë mbetur pa përkrahje prindërore, e pastaj edhe me mbështetjen financiare që po u ofrohet. Edhe ne jemi që në vazhdim me rritjen e Buzhetit të rritet edhe shuma mujore për përkrahjen e tyre. Ne do ta përkrahim dhe do ta votojmë këtë vendim.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi:** Konstatoi Kuorumin prej 17 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* **Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 04.07.2024, unanimisht miratoi, Vendimin për ndarjen nga 100 € për ç'do muaj, për secilën familje që ka strehuar fëmijë pa përkujdesje prindërore në Komunën e Shtimes, deri më 31.12.2024.**

#### Pika 6

##### Informatë nga KKSB për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershori 2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha z.Faruq Beqa.

**Nënkyetari, z.Faruq Beqa;** Përshëndetje, Më lejoni që para jush si Kuvendarë të paraqes një informatë të KKSB-së për gjashtë mujorin e parë të 2024. KKSB-ja deri në këtë periudhë ka mbajtur gjithsejt tri mbledhje, ku janë trajtuar shumë tema, siç janë Siguria, komunikacioni, etj. Nga përfaqësuesi i policisë në KKSB-ë janë raportuar 20 vjedhje, ku si dukuri ka ra në sy vjedhja e baterive të antenave të valëve telefonike. Në vazhdim tha se informatën e keni pranuar të shkruar dhe e keni lexuar prandaj unë do të përmend vetëm pikat kryesore, dhe nëse ka pyetje do të përgjigjem, (Shih dokumentin).

**z.Muhamed Ademaj;** E falënderoj Nënkyetarin për informatën. Na gjëzon fakti që e kemi një gjendje stabile dhe e sigurtë e sigurisë në Komunën tonë. E përgëzoj Policinë për angazhimin që po e tregojnë në ruajtjen e sigurisë, sidomos tash kur veq fillon sezoni kur vijnë bashkëdhatarët tanë në vendlindje.

**z.Përparim Ramusa;** E përshëndes dhe e falënderoj Nënkyetarin për informatën, ne të mirëpresim në Kuvend. Kur flitet për KKSB-në mendja më shkon te Policia, të cilët i përshëndesim dhe i falënderojmë edhe Policinë, edhe Zjarrfiksat, edhe Kompaninë e Ujësjellësit "Prishtina", ku punojnë njerëz të ndershëm dhe me kredibilitet të cilët i falënderojmë, edhe pse ne sigurisht që nuk mund të jemi 100% të kënaqur.

**z.Besnik Seferi;** Edhe unë i përshëndes Policinë, Zjarrfiksat dhe ata të Kompanive publike. Mendoj se është një çështje serioze që nevoitet të trajtohet edhe aspekti i sigurisë nga qenët Endacak sidomos për fëmijët, por edhe kaosi që po krijohet nga mbeturinat që po i shpërndajnë Qenët Endacak gjithandej. Kam një pyetje, a është diskutuar çështja e barrierave në disa rrugë sine fshatin Petrovë, Mollopolc etj. Edhe në Komunën e Shtimes, ka njohuri se po përdoren mjete narkotike, far masa po ndërrmirren për parandalimin e kësaj të keqe, thash fatkeqësisht njihet për përdorim të narkotikëve. Kjo është një gjë shqetësuese, sepse ndoshta ne nuk po e bëjmë atë që është e mundur të bëhet.

**znj.Adelina Beqaj;** I falënderoj për iniciativat që u përmenden për Policinë e Zjarrfiksat por duhet të përmenden edhe punëtorët e QPS-së. Pytja ime është cilat janë hapat që i keni ndërrmarrë për sa u përket punëtorëve të QPS-së, për tua mundësuar një punë normale. Për grata që duhet të strehohen ato kanë fëmijë dhe unë po kërkoj që tu jepet një shumë e caktuar për ushqim, për këto gra që nuk e kanë mundësinë se ku të strehohen.

**z.Rahman Jakupi;** Raportin e vlerësoj si pozitiv, edhe pse ka mundur të jetë më i strukturuar. Prezantimin e Komendantit të Policisë e ka bërë mjaftë mire. Në përgjithësi nuk ka pas cënim të sigurisë, që falënderimi i takon Stacionit të Policisë në Shtime por edhe të tjerëve. Mendoj se këtu mund të bëhet punë edhe pak më tepër.

**z.Kadri Emini;** E falënderoj Nënkyetarin për informatën. Unë mendoj se duhet të marrim masa edhe ne si Kuvend për sa i përket vendosjes së kamerave të sigurisë. Në këtë periudhë përfat të

mire nuk ka pas tē ndodhura krime të rënda, dhe kjo nuk është përgjigje vetëm e polisë por edhe e jona.

**Nënkyetari, z.Faruk Beqa;** Për sa i përket problemit me qenët endacak, ne kemi folë me Drejtorinë e Bujqësisë, kemi pas një kërkesë për Firmat të cilat mund tē i trajtojnë qenët endacek por nuk po paraqitet ndonjë firmë e licencuar. Sa i përket barrierave të vendosura në disa rrugë kemi folë me z.Albert Ramadanin, ku ai na ka thënë se ka mundësi që me gjetë një donatorë që do tē na ndihmonte edhe pér barrierat por edhe pér shenjat e komunikacionit. Sa i përket problemit të narkotikëve, është e vërtetë se tē gjithë duhet tē angazhohemi sepse vetëm Policia nuk mundet me ia dalë e vetme, po ashtu duhet bërë thirrje pér qytetarët që tē bashkpunojnë me policinë pér këtë dhe çështje të tjera. Sa i përket pyetjes së Adelinës pér QPS-në, pritet që disa përgjegjësi ti kalojnë Ministrisë së Drejtësisë, dhe do tē shohim në vazhdim se si do tē rrjedhin punët. Duhet tē mendohet finansiarisht pér viktimat e dhunës.

### Pika 7

#### Pyetje-Përgjigje

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin pér këtë pikë.

**z.Muhamet Ademaj;** Kam këtë pyetje pér DPUKGJ-në, kur do tē fillojë projekti i ndërtimit të kanalizimit në lagjen Ademaj?

**znj.Besartë Musliu-Spahija;** Kam këto pyetje pér DSHP-në, pyetja vjen nga banorët e fshatit Belinc, pér rrugën “Skenderbeu” pse nuk po funksionon ndriqimi në atë rrugë, edhe kush merr përgjegjësi pér shtyllat që janë tē dëmtuara në atë rrugë dhe paraqesin rezik pér banorët? Pyetja tjetër pér DPUKGJ-në, është kërkesë e vazdueshme pér rrugën “Ismajl Qemajli” kur do tē bëhet rregullimi, asfalltimi e trotuarit kjo është kërkesë e shtruar disa herë në Kuvend, dhe përgjigja e juaj ka qenë se do tē bëhet në vitin tjetër, pra cila është arsyaja që nuk është bërë?

**z.Besnik Seferi;** Kam këdo pyetje, pér DSHP-në, a po planifikohet tē bëhet dezinsektimi? Pyetja e dytë pér DPUKGJ-në, kurë do tē bëhet renovimi i rrugës “Hamëz Jashari” në Mollopolc, sepse është demoluar, kjo është shtruar para 13-14 viteve dhe ka nevojë pér renovim? Pyetja e tretë pér DPUKGJ-në, është pér rrugën kryesore në Carralevë, ku është shembur një pjesë e rrugës dhe paraqet rezik pér kalimtarët me automjete, kjo eshte në kuadër të Ministrisë, por cilët janë hapat e juaj pér ta eliminuar këtë rezik pér kalimtarët me automjete? Pyetja tjetër pér DPUKGJ-në, te rruga “17 Shkurti” në Godanc tē poshtem, kanë mbetur pa u asfaltuar disa rrugica, këtë shqetësim e kanë ngritur disa banorë tē atyre rrugicave se a janë tē planifikuara që tē asfaltohen?

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Kam konfirmim nga drejtorat se pyetjet do ti kthejnë me shkrim, Meqenëse pér këtë pikë nuk kemi diskutime atëherë mbledhjen e përfundoi në ora: 15:43h.

Procesmbajtësi  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi